



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

Nr. prot

Tiranë më 24 .09.2007

V E N D I M

Nr. 56 Datë 24. 09.2007

Për

“ Ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës”

Në zbatim të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 45, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij të datës 24.09.2007, shqyrtoi Raportin e Grupit të Punës për përfundimin e procedurës së Hetimit Paraprak, të hapur me Vendimin Nr. 3, datë 27.04.2007 të Sekretarit të Përgjithshëm dhe rezultatet e inspektimeve të kryera, prej nga:

K O N S T A T O I :

Ndërmarrjet nën hetim kanë nënshkruar një marrëveshje e cila:

1. Fikson çmimet e shitjes së betonit sipas markave:

a. Marka 200	65 Euro/metër kub
b. Marka 250	67 Euro/metër kub
c. Marka 300	72 Euro/metër kub
2. Rrit çmimet e betonit me 2 euro për metër kub, për shkak të rritjes së çmimit të çimentos me 6 Euro për ton përfshirë TVSH-në ;
3. Vendos kushte të tjera tregtimi, siç janë ndalimi i kreditimit për firmat ndërtuese të cilat janë debitore ndaj firmave anëtare të Unionit të Prodhuesve të Betonit,

sjellje të cilat janë në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja d dhe nenin 45 të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

V E N D O S I:

1. Ndalimin e Marrëveshjes së lidhur më datë 15.07.2006 ndërmjet ndërrmarjeve prodhuese të betonit në Qarkun e Tiranës, më konkretisht midis : “Alba-Beton” Sh.p.k, “Ani” Sh.p.k, “Alban Tirana” Sh.p.k, “Beststar” Sh.p.k, “Beton Expres” Sh.p.k, “Delia”, “Eurovin”, “Eurobeton” 2005, “Euroline”, “Ferro-Beton”, “Halili”, “Ital-Beton Construction”, “Kirchberger”, “Kdk”, “Qarri”, “Tirana-Beton”, “Sina 98”, “Shkodra Beton”.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për vazhdimin e hetimit për të përcaktuar pasojat e veprimit antikonkurrues dhe njoftimin e palëve të përfshira në këtë hetim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot me datë 24.09.2007

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush PËRPALI

(_____)
Zv/kryetar

Servete GRUDA

(_____)
Anëtar

Koço BROKA

(_____)
Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R